



ДРЖАВЕН ЗАВОД ЗА РЕВИЗИЈА  
ENTI SHETËROR I REVIZIONIT  
STATE AUDIT OFFICE

## Abstrakti i raportit përfundimtar i revizionit

### Subjektet kyçe të përfshira në raportin e revizionit:

Institucioni Komunal Publik Shtëpi për persona të moshuar Kiro Krsteski Pllatnik – Prilep.

### Lënda e revizionit:

Revizioni i raporteve financiare bashkë me revizionin e pajtueshmërisë së llogarisë së buxhetit të aktiviteteve të vetëfinancuara (787) për vitin 2021.

### Qëllimi i revizionit:

Nëse raporti financiar është i liruar nga paraqitjet e gabuara materialisht dhe nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet në to janë në pajtim me rregullativën ligjore.


### Gjendjet kyçe të konstatuara:

- nuk janë miratuar procedura të shkruara për rregullimin e proceseve të punës në pjesën e punës financiare dhe materiale;
- mungojnë norma dhe llogaritje të shpenzimeve të produkteve të nevojshme ushqimore, një pjesë e listës së ushqimit nuk është aprovuar dhe nuk është siguruar plotësim i plotë i normave të përcaktuara për vlerën ushqimore të ushqimit për personat e moshuar.

### Rekomandimet kyçe:

- Rregullimi dhe harmonizimi i akteve të brendshëm dhe vendosjen e kontrollit në pjesën e punës financiare dhe materiale, si dhe implementimi i tyre;
- Krijimi i normativit dhe përgatitja e llogarive të shpenzimeve dhe përgatitja e listës së hajes në vazhdimësi.

### Mendimi i dhënë/konkluzioni \*:



Mendim pa rezervë në lidhje me vërtetësinë dhe objektivitetin e raporteve financiare dhe mendim me rezervë për pajtueshmërinë e transaksioneve financiare me rregullativën ligjore relevante.

### Theksimi i çështjes për vazhdimësi dhe pasiguri:

- Në vitin 2017, pas 17 vjetësh, për herë të parë, Shtëpia rriti çmimet e akomodimit dhe i përshtati ato me rritjen e shpenzimeve të punës, të cilat ndërkohë janë rritur ndjeshëm;
- Shërbimi i përgatitjes së ushqimit për projektin "Kuzhina Popullore" ofrohet nga Shtëpia me të njëjtin çmim të përcaktuar në fillim të projektit në vitin 2007 dhe me të njëjtin staf në kuzhinë, i cili nuk është i mjaftueshëm as për **përdoruesit** e rregullt;
- në tre tremujorët e parë të vitit 2021 është blerë një sasi disa herë më e madhe barnash dhe pelenash në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit aktual 2022.

### Vërejtjet e marra të draft-raportit:

Nuk janë marrë vërejtje për Draft-Raportin e revizorit të autorizuar shtetëror numër 22 – 124/9 nga 05.12.2022.

\*



pozitive,



me rezervë



të pavolitshëm



të përmbajtur